



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRA	
01 Nr. / Br	94/21
Nr. i fq. / Nr. st	- 7 -
Data: / Datuma	29.04.2021
VUSHTRRI - VUČITRA	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 16 PRILL 2021**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 14:10.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:  
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agim Krasniqi, Ali Januzi, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fitim Halili, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Miljan Bojković, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylja Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Mungoi:** Fatmire Saraçi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri nënkryetari i komunës z. Afrim Namani, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-në emër të grupit kuvendar të Lëvizjes Vetëvendosje paraqiti një raport të të gjeturave lidhur me punën dhe aktivitetin e komisionit për vlerësimin e ofertave për përzgjedhjen dhe vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh. Në mbledhjen e parë të këtij komisioni të mbajtur më datën 05.03.2021 me fillim nga ora: 8:30, ka munguar ai në cilësinë e anëtarit të komisionit për shkak të gjendje së rëndë shëndetësore që ka pasur ai si pasojë e virusit covid-19. Për këtë takim që iu është cilësuar si jo formal, ka munguar edhe Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, në bazë të procesverbalit të nënshkruar nga pesë anëtarët e komisionit shihet se në këtë takim është bërë hapja e ofertave apo aplikacioneve, verifikimi i dokumentacionit të nevojshëm për aplikim në bazë të vendimit për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh siç janë: Formulari i plotësuar me të dhënat e kërkuara Certifikata e regjistrimit të biznesit, Historiati i kompanisë (biznesit), Veprimtaria që do ta zhvillojë dhe Projekti ideor, në procesverbal thuhet se në bazë të këtyre kritereve komisioni bëri klasifikimin

e bizneseve duke konstatuar se a i plotësojnë kriteret e kërkuara sipas vendimit të kuvendit dhe duke identifikuar numrin e punëtorëve dhe vlerën investuese për secilin aplikues. Andaj në këtë rast rikujtoj se kriteret sipas vendimit të kuvendit janë: Punësimi 40 pikë; Vlera investive 30 pikë; Lloji i veprimtarisë 30 pikë; *Prodhuese 30 pikë, Përpunuese 20 pikë, Shërbyese 10 pikë*. Gjithashtu nga procesverbali del se nuk janë marrë parasysh kriteret për vlerësim, sepse bizneset që kanë fituar nuk i kanë të vendosura pikët e marr sipas këtyre kriterëve dhe nuk e kanë sipërfaqen e pronës të cilën e kanë marr në shfrytëzim sipas këtyre kriterëve. Më datën 12 .03.2021 në ora:15:40, është mbajtur takimi i dytë i Komisionit për vlerësimin e ofertave, ka qenë prezent vetë ai dhe anëtarët tjerë, në takim ishte prezent edhe një zyrtar nga Kallxo.com. Në këtë takim kryesuesi i komisionit z.Adan Lahu informoj anëtarët e komisionit se 22 aplikant kanë plotësuar dokumentacionin, pa specifikuar numrin e pikëve sipas kriterëve të përcaktuara në konkursin publik dhe pa treguar sipërfaqen që kanë fituar bizneset. Nga 43 biznese sa kanë aplikuar 21 prej tyre nuk e kanë plotësuar dokumentacionin, është cekur se 13 biznese kanë kërkuar pronë në sipërfaqe deri 50 ari, 6 biznese kanë kërkuar prej 51 ari deri 1 hektarë, dhe tre aplikant kanë kërkuar mbi 1 hektarë pronë në shfrytëzim. Në procesverbal nuk është konstatuar se ka konkurruar një konsorcium të cilës ia nda 1.5 hektar tokë. Nga 22 biznese sa janë përzgjedh 18 janë nga Vushtrria, 2 janë nga Mitrovica dhe 2 nga Prishtina. Në mbledhje është konstatuar se anëtari i komisionit nga radhët e PDK-së z.Ilmi Azemi ka konflikt interesi me biznesin Mateo Company SH.P.K., dhe i njëjti nuk ka marr pjesë në votim kur është votuar për atë biznes ndërsa për bizneset tjera ka marr pjesë. Në mënyrë unanime është votuar lista me 22 biznese të cilat kanë ofruar 783 punëtor ndërsa vlerë investimeve 21,03.000.000 €, pa u theksuar numri i pikëve që ka qenë kriter dhe sipërfaqja të cilën e kanë fituar. Në mbledhje na është thënë se caktimi i lokacionit dhe paralizimi do të bëhen në kuvend sipas kërkesave të bizneseve dhe do të bëhet projekti nga Drejtoria e Kadastrit. Nga ajo që u tha më lartë shihet se komisioni nuk i ka marrë parasysh kriteret për vlerësim në përcaktimin e sipërfaqes që ka përfituar biznesi. Biznesi Unikonzum, ka ofruar 15 punëtor ka kërkuar 50 ari sipërfaqe të pronës dhe ka fituar 50 ari, biznesi B.t.p. Holding SH.P.K. ka ofruar të punësoj 15 punëtor, ka kërkuar 50 deri në 70 ari ndërsa ka përfituar 50 ari, biznesi Euro Driloni, ka ofruar 19 punëtor ka kërkuar 45 ari ka fituar 40 ari, biznesi Ajna Cake SH.P.K., ka ofruar punësimin e 21 punëtorëve ka kërkuar 65 deri 70 ari ndërsa ka përfituar 65 ari, biznesi Solid Group SH.P.K. ka ofruar të punësoj 30 punëtor, ka kërkuar 1 hektar tokë dhe ka përfituar 1 hektar, biznesi Timber Home SH.P.K, ka ofruar të punësoj 41 punëtor, ka kërkuar 40 deri 50 ari dhe ka përfituar vetëm 25 ari, biznesi Vazo SH.P.K., ka ofruar të punësoj 42 punëtor, ka kërkuar 70 ari deri 1 hektarë ndërsa ka përfituar 31.45 ari, biznesi Time SH.P.K ka ofruar 61 të punësuar, ka kërkuar 80 ari deri në 1 hektar ndërsa ka përfituar 60 ari, biznesi Bvd Ing. SH.P.K. ka ofruar të punësoj 140 punëtor, ka kërkuar 80 ari deri 1 hektar dhe ka përfituar 60 ari. Në këtë kuadër shihet një disbalancë dhe mos respektim i kriterëve. Po ashtu ka përfituar pronë një konsorcium për të cilin nuk ka pas shpallje publike dhe në takimet e komisionit fare nuk është diskutuar. Në mbledhje janë prezantuar se do të punësohen 783 punëtor ndërsa tani po prezantohet se do të punësohen mbi 800 punëtor. Po ashtu konsorciumi IFA, ka përfituar 50 ari sipërfaqe, kurse në asnjë procesverbal dhe në dokumente zyrtare nuk kemi informacione për këtë biznes. Nuk kemi informacione të bollshme edhe sa i përket bizneseve të cila janë refuzuar. Në raport është thënë se kemi finalizim të punimeve në Parkun Industrial, gjë e cila nuk është e vërtetë sepse akoma nuk është bërë rregullimi i rrethojës, ndriçimi dhe rryma elektrike, rregullimi i kanalizimit dhe rregullimi i asfaltit. Pastaj ai adresoi kërkesën e banorëve të fshatit Lumadh që kanalizimi i Parkut Industrial të ndahet nga kanalizimi i fshatit të rregullohet ura dhe rruga e cila është dëmtuar gjatë punimeve dhe po ashtu të rregullohet kanali deri në lumin “Llapë” sepse një kanal i tillë i cili është brenda zonës

ekonomike me sa të madhe të ujit paraqet rrezik për fëmijët e këtij fshati. Duke i parë këto të gjetura dhe duke ditur se disa kompanive iu është kërkuar edhe mito dhe korrupsion, gjë për të cilën ai ka qenë i informuar nga këto kompani, por në dijeni ka qenë edhe kryetari i komunës, andaj për këtë ai shpreson se kryetari i komunës, këtë rast do ta denoncon në polici dhe prokurori. Po ashtu deklaroi se është i gatshëm ai dhe Lëvizja Vetëvendosje që bashkëpunojnë me prokurorinë dhe policinë për zbardhjen e këtyre rasteve. Nga të cekurat më lartë kërkojë që kjo mbledhje të shtyhet duke i hapur rrugë fillimisht prokurorisë së shtetit që ta hetoj këtë proces për çka edhe do jenë të gatshëm të bashkëpunojnë ai dhe grupi kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje.

***Në vazhdim të mbledhjes anëtarët e grupit kuvendar të LVV-së lëshuan mbledhjen e kuvendit në mënyrë demonstrative.***

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit**-tha se kjo ngjarje në këtë mbledhje të jashtëzakonshme, që është e rëndësishme së veçantë do të kishte peshën e rëndësishme të saj, sikur ajo të ishte përkrahur nga të gjithë anëtarët e kuvendi pa ngjyrimet politike dhe të ishte si një ngjarje festive. Për këtë projekt të gjithë jemi munduar në realizimin e tij dikush me herët e dikush tani dikush më shumë e dikush më pak, por që tani jemi në përfundim por që përfundimi i tij është dashur të jetë gjithëpërfshirës dhe vërtet një lajm i jashtëzakonshëm për Komunën e Vushtrrisë. Partia Demokratike e Kosovës edhe gjatë kohës sa ka qeverisur komunën, është munduar që sa do pak tu dal në ndihmë bizneseve të komunës me të gjitha të drejtat që i kemi pasur sipas ligjit e që njëri nga vendimet e kuvendit ka qenë për heqjen e taksës në firmë për bizneset e Vushtrrisë që është votuar në mënyrë unanime nga të gjitha subjektet politike. Edhe sot ku por flitet për parkun industrial në Lumadh PDK-ja ka dhënë kontributin e saj qoftë duke i votuar pika që janë lidhur me këtë projekt qoftë duke marrë pjesë në komisionin që ka bërë vlerësimin e ofertave. Mirëpo sa i përket votimit të sotëm PDK ka hezitimet e saj, sepse në jemi që ky proces të përmbyllet në mënyrën më të mirë të mundshme që bizneset që do të vendosen atje të iu krijojmë kushte ashtu që ato të operojnë në mënyrën më të mirë, por në kushtet aktuale të këtij projekti, bizneset tona po iu lëmë një barrë të rënd mbi supet e tyre. Sipas informatave që i posedon e që janë publike vlera që është dhënë për përfundimin e punimeve në këtë projekt është afër 1.5 milion euro, e që me këto mjete është dashur të rregullohet infrastruktura e përgjithshme e që nënkupton: ujin, kanalizimin, rrugët, ndriçimin dhe punën tjera të cilat janë ndoshta në proces e sipër, ndër të tjera ka qenë edhe mbushja e sipërfaqes ku do të vendosen bizneset, sepse nëse bëjmë një analizë dhe llogari të thjesht secili biznes që do të jetë përfitues do ti duhet që vetëm për punë përgatitore për mbushjen dhe rregullimin e terrenit për një sipërfaqe prej 50 ari që është e barabartë me 5000 m<sup>2</sup>. Thellësia që ka mbetur aktualisht është 1.5 metra e që i bie që një biznes për punë përgatitore të vendos rreth 7500 metër kub një biznes duhet të shpenzoj 112,500.00 € sepse 1 kubik i zhavorrit kushton rreth 15 euro. Këto punë është dashur ti kryen komuna në bashkëpunim me ministrinë e linjës por që fatkeqësisht këto punë janë shumë larg përfundimit. Grupi kuvendar i PDK-së është për ti ndihmuar bizneset por jo në këtë formë, nëse ju deklaroni se këto punë do të kryhen kjo fletë edhe më keq, sepse pas bisedave që kanë pasur me shumë biznese, arsyeja e tyre për mos aplikim ka qenë sepse ka shumë punë përgatitore në atë park industrial dhe ka kosto të larët investive për ta përgatitur trenin për të zhvilluar biznes, ato në rrethana tjera do të aplikonin sikur ti ishin përfunduar këto punime, por kjo i bie <sikur ju kemi hedhur hi syve këtyre bizneseve>. Partia Demokratike e Kosovës do të votoj pro kësaj pike atëherë kur do të përmbyllen këto investime në atë zonë ekonomike dhe atëherë kur të kenë të qartë bizneset statusin e tyre të pronës në përgjithësi dhe të parcelave në veçanti. Ata të cilët e kanë me nguti këtë punë, le të iu tregojnë të vërteten

atyre që iu kanë premtuar dhe njëkohësisht të ndalen satelitët e tyre në mënyrë që ky projekt të përmbillet në mënyrën më të mirë të mundshme. Në fund ai njoftoi se si grup kuvendar i PDK-së nuk do të marrin pjesë në mbledhje përderisa këto investime nuk do të përfundohen vota e tyre do të jetë kundër.

*Në vazhdim të mbledhjes një pjesë e anëtarëve të grupit kuvendar të PDK-së lëshuan mbledhjen e kuvendit në mënyrë demonstrative.*

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se para vetës kemi për shqyrtim rekomandimin e Komisionit për vlerësim të ofertave për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh, dhe se ky komision në saj të punës së tij për pronat dhe parcelat e caktuar e sjell para kuvendit këtë rekomandim. Pastaj shtoi se është i çuditshëm fakti dhe pyeti kryesuesin e këtij komisioni se këtë rekomandim a ka hartuar komisioni apo krye ne veti ka vepruar secili anëtar. Megjithatë në procesverbal thuhet se komisionin me votim unanim ka përkrahur dhe votuar vendosjen e bizneseve në Zonën Ekonomike gjithsejtë 22 biznese dhe kërkon nga kuvendi i komunës që ashtu siç është vendosur nga ana e komisionit të jep mbështet në aprovimin e këtij rekomandimi përkatësisht propozim-vendimin për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh, ashtu që ti jepet mundësi punësimi dhe zhvillimit. Andaj pyetja e tij ishte se a ishin të përfshirë përfaqësuesit e tri partive më të mëdha të përfaqësuar në komision ata të PDK-së, LDK-së dhe LVV-së, dhe tani del përfaqësuesi i LVV-së anëtar i komisionit dhe deklaroi krejt diçka tjetër nga ajo që ka nënshkruar në rekomandim dhe procesverbal. Më tej vlerësoi se këto lojëra politike të LVV-së dhe PDK-së janë të papranueshme andaj kërkoi nga kryesuesi i komisionit që të jap sqarime se çfarë në të vërtetë po ndodh lidhur me këtë çështje. Ai në fund u zotua se gjithëherë do të votojë pro një projekti i cili është në të mirë të qytetarëve të komunës së Vushtrrisë.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-sqaroi se anëtari i komisionit nga radhët e LVV-së z.Ymer Haradinaj, ka munguar në njërin nga mbledhjet e komisionit për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, por menjëherë në mbledhjen vijuese iu është ofruar qasje në të gjithë dokumentacionin e projektit dhe për secilin biznes që ka qenë i interesuar. Pastaj shtoi se ky komision është votuar nga po ky kuvend dhe tani nuk e kupton se përse ka kaq shumë mosbesim, kur dihet fakti se i gjithë dokumentacioni ka qenë transparent dhe i qasshëm për të gjithë kush ka qenë i interesuar ka mundur të lexoj ato. Ai përsërit se 22 bizneset e cekur në propozim-vendim, i kanë plotësuar të gjitha kushtet sipas konkursit publik të shpallur nga kuvendi i komunës duke arritur pikët maksimale nga 100 sosh. Ndërsa 21 biznese tjera kanë pasur mangësi në dokumentacion dhe në veprimtari të tyre dhe kështu nuk i kanë arritur pikët maksimale. Andaj sa i përket punës së komisionit, mund të thuhet se edhe përfaqësuesi i LVV-së i ka dhënë mbështetje të fuqishme projektit dhe punës së përbashkët të komisionit në kuptim të punësimi dhe zhvillimit ekonomik të qytetit tonë. Lidhur me punën e mirë që është bërë përfaqësuesja e BIRN-it i kishte dhënë kompliment komisionit për punë e mirë që kanë bërë. Sa i përket mbushjes së trenti në parkun industrial me zhavorr në dosjen tenderues është e planifikuar kjo punë 13600 metra kub janë të parapara me aneks kontratë dhe 13600 m<sup>2</sup> janë paraparë që të rrafshohen me dendësinë e paraparë ligjore. Në fund kërkoi që mos të sfidohet komisioni dhe ti jepet përkrahej këtij projekti.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së**- në cilësinë e kryetarit të komisionit për vlerësimin e ofertave lidhur me dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në Parkun Industrial në Lumadh, falënderoi anëtarët e komisionit për punën e bërë. Dhe shtoi se ky proces që nga fillimi është karakterizuar me transparencë të plotë, dhe se i gjithë dokumentacioni ka qenë transparent

dhe qasshëm për gjithë të interesuarit. Ai vlerësoi se nuk e kupton këtë qaje në kuvend që po tentohet që ky projekt të politizohet skajshmërisht. Kërkoj që kjo gjendje të tejkalohet dhe ky projekt të votohet nga kuvendi pasi është në të mirë të qytetarëve.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-njoftoi kuvendin se ai do të qëndroj në sallën e kuvendit, por vota e tij do të jetë *abstenim* me qëllim të shmangies të konfliktit eventual të interesit. Sepse kjo parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, por ai do të marr pjesë, por që vota e tij nuk dëshiron të jetë përcaktuese në kahjen e këtij vendimi që do të merret.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit**-tha se ndihet shumë krenar për punën që ka bërë në komision për vlerësimin e ofertave lidhur me Parkun Industrial në Lumadh, dhe shtoi se asnjëherë në jetën e tij nuk ka bërë punë më të mirë, për faktin se i ka hupur rrugë biznesit dhe zhvillimit ekonomik të qyteti në saje të shtyrjes përpara të këtij projekti. Ai ceku se i vjen shumë keq për kolegun e tij nga LVV-ja që ka qenë pjesë e komisionit, i cili mendon se në kohën kur ka nënshkruar në komision ka qenë në gjendje të agonisë nga covid-19 dhe se vota e tij duhet të verifikohet.

**Fitim Halili, anëtar i kuvendit**-deklaroi se për shkak të konfliktit të interesit eventual lidhur me vendimmarrjen njoftoi se vota e tij do të jetë *abstenim*.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit**-konstatoi se në sallën e kuvendit ndodhen 19 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për të marr vendim të plotfuqishëm. Pastaj saktësoj se ai do të qëndroj në sallë të kuvendit për ta kryer detyrën e tij zyrtare në cilësinë e kryesuesit të kuvendit, por se ai nuk do të marr pjesë fare në votimin e kësaj pike të rendit të ditës.

***Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë pas votimit me 14 vota "për" 1 votë "kundër" dhe 3 vota "abstenim" aprovoi këtë:***

## REND DITE

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për vlerësim të ofertave për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh.

*Pas shqyrtimit të pikës së lartë cekur të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 13 vota "për" 2 vota "kundër" 3 vota abstenim dhe 1 nuk mori pjesë në votim vendosi me sa vijon:<sup>1</sup>*

**1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh bizneseve private, nga parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

<sup>1</sup> Lidhur me numrin e votave sqarojmë se Kryesuesi i kuvendit fillimisht kishte konstatuar se propozim-vendimi për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për bizneset në Parkun Industrial në Lumadh, kishte marrë 14 vota "për", por pas shikimit të video-incizimit, Sekretaria e Kuvendit ka gjetur se propozim-vendimi në fjalë ishte aprovuar me 13 vota "për", 2 vota "Kundër" 3 vota "abstenim" ndërsa kryesuesi i kuvendit nuk kishte marrë pjesë fare në votim.

Për më tepër referencë, keni video-incizimin e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë të mbajtur më datë 16.04.2021, e cila është e publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë në rrjetin social në facebook. Ky është linku i video-incizimit:

[https://www.facebook.com/KomunaVushtrri/videos/1364340727254640/?so=permalink&rv=related\\_videos](https://www.facebook.com/KomunaVushtrri/videos/1364340727254640/?so=permalink&rv=related_videos)

**2. Ngastrat kadastrale si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, iu jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrim të veprimtarive biznesore, si vijon:**

- 2.1. Solid Group SH.P.K.;**
- 2.2. Druri SH.P.K.;**
- 2.3. B.t.p. Holding SH.P.K.;**
- 2.4. Timber Home SH.P.K.;**
- 2.5. Time N.T.P.;**
- 2.6. Unikonzum;**
- 2.7. Mateo Company SH.P.K.;**
- 2.8. Homestar N.T.P.;**
- 2.9. Vazo SH.P.K.;**
- 2.10. Bunsam Metal SH.P.K.;**
- 2.11. Euro Driloni;**
- 2.12. Bina SH.P.K.;**
- 2.13. Ra Eximp SH.P.K.;**
- 2.14. Emona Center SH.P.K.;**
- 2.15. Berto SH.P.K.;**
- 2.16. Te Duli D.P.Z.;**
- 2.17. Trios Group SH.P.K.;**
- 2.18. Bvd Ing. SH.P.K.;**
- 2.19. AH Invest SH.P.K.;**
- 2.20. Ajna Cake SH.P.K.;**
- 2.21. Union SH.P.K.;**
- 2.22. 7 Vëllezërit SH.P.K.**

3. Bizneset e cekura si në pikën paraprake, në tri në 3 vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për m<sup>2</sup> në vit.
4. Prona e paluajtshme e komunës iu jepet në shfrytëzim subjekteve ekonomike në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve.
5. Obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë kontratë me secilin përfaqësues të biznesit të cekura në pikën 2 (dy) të këtij vendimi.
6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: rekomandimi i komisionit vlerësues dhe dokumentacioni shtesë i paraparë me legjislacionin në fuqi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
8. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 14:44.

Bastri Duraku  
  
Procesmbajtës

Nasuf Aliu  
  
Kryesues i Kuvendit

